

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISË TREGTARE**  
**“BELBA GROUP” SH.P.K**

**KREU I**

**Themelimi , Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1 :**

**Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- 1.1.1 Sot më datë **13/03/2023**, unë themeluesi kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“BELBA GROUP” sh.p.k**
- 1.1.2 Themeluesi i shoqërisë është :  
**Erdi Fatmir BELBA**, e datëlindjes **13.06.1992**, shtetas shqiptar i identifikuar me numër personal **J20613063W** nëpërmjet letërnjoftimit elektronik.

**Neni 2 :**

**Objekti**

**2.1 Objekti I Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë**

- “1. Tregëtia me pakicë e të gjitha llojeve të karburanteve, hidrokarbureve, gazrave të lëngshëm, për konsumatorët dhe për përdorim industrial.
2. Shitja-Blerja dhe Qeradhënia brenda dhe jashtë vendit e të gjitha llojeve të mjeteve automobilistike për qëllime tregtare, turistike, industrial, etj “

**Neni 3 :**

**Kohëzgjatja**

- 3.1.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë **pa afat**.

**Neni 4 :**

**Selia**

- 4.1.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:  
**Tiranë, Tiranë, Njësia administrative Vaqarr, Lalm, Magazinë 1-katëshe ZK 2376, nr pasurie 108/32, përballë godinës së njësisë administrative Vaqarr**

*Erdi Belba Buy*

## KREU II

### KAPITALI

#### Neni 5

##### Kapitali themeltar

- 5.1.1 Kapitali themeltar I krijimit të shoqërisë do të jetë **100.000 leke** . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë në përputhje me kontributet e tyre do të jetë si më poshtë :
- Ortakut themelues z. **Erdi BELBA** : Zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme **100.000 lekë** që përbën **100%** të pjesës së kapitalit
  - Kontributi I ortakut mund të jetë në para ose në natyrë, (perfshihen te drejta, pasuri të luajtshme apo të paluajtshme).

#### Neni 6

##### Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit

- 6.1.1 Kapitali I shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar nëpërmjet kontributeve në para dhe kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto Kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 6.1.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur pjesëmarrjen e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.1.3 Zvogëlimi I kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve , e cila merr vendim në të njëjtat kushte në të cilat kërkohet ndryshimi I statutit.
- 6.1.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi I prek ortakët në të njëjtën masë me pjesën e kapitalit që përfaqësojnë.

#### Neni 7

##### Transferimi I kapitalit

- 7.1.1 Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen ose te kalohen nepermjet :
- Kontributit ne kapitalin e shoqerise
  - Shitblerjes se kuotave
  - Trashegimise
  - Dhurimit
  - Cdo menyre tjeter qe parashikon ligji
- 7.1.2 Pjeset e kapitalit jane lehtesisht te transferueshme mes ortakëve, per sa kohe nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 7.1.3 Pjeset e kapitalit jane lehtesisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

## KREU III


### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarres

- 8.1.1 Asambleja e ortakëve është organi I vetem vendimmarres I shoqërisë.
- 8.1.2 Asambleja e ortakëve është organi I vetem vendimmarres I shoqërisë qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne lgj.

Erdi Belba



- 8.1.3 Asambleja e pergjithshme e ortakeve te shoqërisë eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve te meposhtme :
- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqërisë
  - b) Ndryshimet ne statutin e shoqërisë.
  - c) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
  - d) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
  - e) Percaktimin e perfitimeve per personat e permenduar ne piken (c) dhe (d)
  - f) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqërisë dhe raporteve te ecurise tregtare te shoqërisë
  - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore te shoqërisë dhe raporteve te ecurisë së veprimtarisë
  - h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
  - i) Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
  - j) Perfaqesimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne proceset e tjera ndaj administratoreve
  - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
  - l) Miratimin e rregullave proceduriale per mbledhjen e asamblese
  - m) Ceshjte te tjera te parashikuara nga ligji apo ne statut
- 8.1.4 Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person I trete.
- 8.1.5 Administrator I shoqërisë nuk mund te veproje si perfaqesues I ortakeve ne asamblene e pergjithshme te shoqërisë
- 8.1.6 Autorizimi eshte I vlefshem vetem per nje mbledhje te asamblese se shoqërisë, si per mbedhjet vijuese por qe kane te njejtin rend dite te punes.

## **Neni 9**

### **Menyra e thirrjes se asamblese se pergjithshme**

- 9.1.1 Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrim, ose nese parashikohet ndryshe ne statut, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me poste elektronike duhet te permbaje vendin, daten , oren e mbledhjes dhe rendin e dites, dhe t'u dergohet te gjithe ortakve, jo me vone se 7 dite nga data e parashikuar e mbedhjes se asamblese se pergjithshme.
- 9.1.2 Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, asambleja mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime pavaresisht parregullsisë.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**

- 10.1.1 Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.
- 10.1.2 Ne rastet kur asambleja duhet te marre vendime te cilat kerkojne shumice te cilesuar , sipas Nenit .87 te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese apo me elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te Nenit te ketij ligji.
- 10.1.3 Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungese se kuorunit te permendur me lart, asamblej mblidhet perseri jo me vone se 30 dite , me te njejtin rend dite.

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

Erdi Belba 

- 11.1.1 Asambleja e pergjithsme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votive te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.1.2 Asambleja e pergjithsme vendos me shumce te votave te ortakeve pjesemarres per vendime te tjera si :
- Percaktimi I politikave tregtare te shoqërisë.
  - Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
  - Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar.
  - Percaktimin e shperblimeve.
  - Mbikqyrjen e politikave tregtare nga ana e administratoreve, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se se veprimtarise tregtare.
  - Perfaqesimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procese te tjera ndaj administratoreve
  - Miratimin e rregullave proceduriale ne mbledhjen e asamblese.

Çdo ndryshim ne statut duhet pasqyruar ne QKB per te bere ndryshimet ne skeden tregtare te shoqërisë.

## **Neni 12**

### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

- 12.1.1 Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithsme merr vendim si me poshte :
- Vleresimin e veprimtarise se tij
  - Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
  - Ngritje e nje padie ndaj tij nga shoqeria
  - Dhenien ose jot e perfitimeve te reja
- 12.1.2 Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues I autorizuar, perfaqesuesi vleresohet qe te jete ne te njejtin konflikt interesi ashtu si edhe ortaku qe perfaqeson.

## **Neni 13**

### **Administrimi**

- 13.1.1 Asambleja e pergjithsme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqërisë. Afati I emrimit eshte 5 (pese ) vjet, me te drejte ripertertitje. Emerimi I administratoreve prodhon efekte pas rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.
- 13.1.2 Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas parashikimit Nenet. 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar dhe anasjellas. Cdo emerim qe bie ne kundërshtim me dispozitat e mesiperme eshte I pavlefshem.
- 13.1.3 Personat e meposhtem caktohen si administrator te pare te shoqërisë deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare nga Asambleja e Pergjithsme.

Te dhenat e identifikimit  
(Emri, Atesia mbiemri, datelindja)  
**Erdi Fatmir BELBA**  
**13.06.1992**

dhe specimenet e nenshkrimit  
(nr. I identifikimit, nenshkrimi)  
**J20613063W**

## **Neni 14**

### **Kompetencat e administratoreve**

- 14.1.1 Administratoret kane te drejte e detyrohen te :
- Te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te aktivitetit tregtar te shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithsme.

Erdi Belba




- b) Perfaqesojne shoqerine tregtare
  - c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqërisë.
  - d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor te kompanise, bilanci e konsoliduar, dhe raportet e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim
  - e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercononje mbarevajtjen dhe ekzistence e shoqërisë.
  - f) Kryejne rregjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqërisë, sic parashikohet ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit".
  - g) Raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqërisë tregtare.
  - h) Kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
- 14.1.2 Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur :
- a) Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqërisë nuk I mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
  - b) Shoqëria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te madhe sesa 5% e vleres se aktiveve te shoqërisë, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
  - c) Shoqëria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak asetete, te cilat kane nje vlere me te madhe sesa 5 % e aktiveve te shoqërisë qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 14.1.3 Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume sesa nje administrator, ata e administrojne bashkarisht shoqerine.
- 14.1.4 Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje ne cdo kohe administratorin me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin ndaj administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## **Neni 15**

### **Pergjegjesite e administratorit**

- 15.1.1 Administratoret eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per fje te konsumuara gjate administrimit te shoqërisë.
- 15.1.2 Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja e pergjithshme qe I sjellin dem shoqërisë, I ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit, pasojat perkatese.
- 15.1.3 Pervец sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17, 18, te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet :
- a) Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut, ne mirebesim e ne interes per me te miren e shoqërisë, duke I kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqërisë ne mjedis.
  - b) Te ushtroje kompetencat qe I njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
  - c) Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim
  - d) Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezente apo te mundshem, te interesave personale me ato te shoqërisë.
  - e) Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdes te nevojshem
- 15.1.4 Administratori gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet per cdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqërisë tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
- 15.1.5 Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 3 e 4 te ketij neni, eshte I detyruar te demshperbeje shoqërisë demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ai ose personat e lidhur me te kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administrator ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te

Erol Belba



- rregullt, e sipas standartave te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ne menyre solidare.
- 15.1.6 Ne menyre te vacante, por pa u kufizuar ne to, administrator eshte I detyruar ti demshperbleje demet e shkaktuara shoqërisë, nese ne kundershtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” kryen veprimet e meposhtme :
- a) U kthen ortakeve kontributet.
  - b) U paguan ortakeve dividend ose interesa
  - c) U shperndan aktivet e shoqërisë
  - d) Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare kur, ne baze te gjendjes financiare , duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese ndaj detyrimeve.
  - e) Jep kredi
- 15.1.7 Përveç padise per shlyerjen e demit qe I ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale ndaj administratorit.
- 15.1.8 Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe I eshte shkaktuar shoqërisë, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim I asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

## **KREU IV**

### **Viti Financiar – Ekspertet**

#### ***Neni 16***

##### **Viti financiar**

- 16.1.1 Viti financiar I shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar I shoqërisë fillon ne daten e rregjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombetare te Biznesit e mbyllet me 31 Dhjetor.

#### ***Neni 17***

##### **Ekspertet**

- 17.1.1 Eksperti ka per detyre te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqërisë , ate vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike, te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 17.1.2 Ne perfundim te kontrollit , eksperti kontabel I autoriuar, pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor, si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, per te cilat eshte I detyruar qe t’ia paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t’I shlytuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

## **KREU V**

### **Prishja dhe ri-organizimi I shoqërisë.**

Erdi Belha

Buy

## **Neni 18**

### **Prishja dhe likuidimi**

- 18.1.1 Shperndarja ose prishja e shoqërisë ne mund te behet ne cdo kohe :
- a) Kur mbaron kohezhgatja e parashikuar ne themelimin e saj.
  - b) Me vendim te Asamblese se Ortakeve
  - c) Me hapjen e procedurave te falimentimit.
  - d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te te nenit 4, te ligjit nr.9723 dt.03/05/2007 "Per Qendrn Kombetare te Rregjistrimit".
  - e) Me vendim te gjykates
- 18.1.2 Ne kete rast ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likuidimit te shoqërisë, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe duke shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne Likuidim e Siper".
- 18.1.3 Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte hapur nje procedure falimentimi.
- 18.1.4 Likuidimi kryehet nga likuiduesit e emeruar nga ortaket.
- 18.1.5 Nese ortaket nuk marrin nje vendim per caktimin e likuiduesve, brenda 30 diteve nga dita e prishjes, cdo pale e interesuar mund t'i drejtohet gjykates per te caktuar nje likuidues.

## **Neni 19**

### **Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi dhe ndarja**

- 19.1.1 Shoqeria mund te ndahet ose te bashkohet, sipas Vendimit te Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te ligjit nr.9901 dt.14/04/2012 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

## **Neni 20**

### **Baza Ligjore**

- 20.1.1 Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj tregtare ne perputhje te plote me kete statut dhe me legjislacionin shqiptar.
- 20.1.2 Per sa nuk parashikohen ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" , Kodi Civil dhe cfaredo ligj tjeter specific ne Republikën e Shqiperise.

## **Neni 21**

### **Mosmarveshjet**

Per mosmarveshjet qe lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statute, ssi dhe per cdo mosmarveshje qe mund te linde mes Shoqërisë dhe Te Treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

## **ORTAKU**

### **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

"BELBA GROUP" SH.P.K

Erdi BELBA

Erdi Belba 